



## Hyrje

Importet e produkteve organike në BE duhet të shoqërohen me një Certifikatë të Inspektimit (COI), e cila konfirmon se produkti është prodhuar në përputhje me rregullat e prodhimit organik sipas rregullores ekuivalente me rregulloret organike të BE-së.

Pa një COI të lëshuar nga trupa certifikuese e operatorit të fundit në vendin e tretë në sistemin TRACES të BE-së, së bashku me një dokument origjinal të nënshkruar, produktet nuk mund të pranohen nga dogana si organike në BE (Reg. Nr. (EU) 834/2007 dhe 1235/2008).

Për importet organike në SH.B.A., nuk ka kërkesë të përgjithshme për COI të NOP. Sidoqoftë, disa importues mund ta kërkojnë atë si një mjet të sigurimit të cilësisë. Më tej, NOP e kërkon atë për produkte të caktuara nga vende të caktuara.

Një COI duhet të kërkohet nga operatori që kryen veprimin e fundit të përgatitjes së lotit (ruajtjen, përpunimin, paketimin, etiketimin, mbylljen e mallrave në paketim ose kontejnerë).

## Dokumentat e kërkuara për lëshimin e COI

|   |   |
|---|---|
| Për të gjithë kërkesat:   | <ul style="list-style-type: none"><li>Formulari I aplikimit 5.3.010, I cili mund të gjendet edhe në, <a href="http://albinspekt.com/web/wp-content/uploads/5.3.010-Formulari-i-Aplikimit-p%C3%ABr-l%C3%ABshimin-e-%C3%A7ertifikat%C3%ABs-s%C3%AB-inspektimit_191014.docx">http://albinspekt.com/web/wp-content/uploads/5.3.010-Formulari-i-Aplikimit-p%C3%ABr-l%C3%ABshimin-e-%C3%A7ertifikat%C3%ABs-s%C3%AB-inspektimit_191014.docx</a></li><li>Fatura e shitjes / Lista e paketimit</li><li>Bill of lading/Airway bill (outgoing goods)</li></ul> |
| Dokumentat shtese, për shitjet e produkteve të blera nga operatorë të tjerë | <ul style="list-style-type: none"><li>Prodhuesi deklorohet në fushën 2 të aplikimi për Col</li><li>Fatura e blerjes së produkteve<sup>1</sup></li><li>National Col (kur blerja kryhet nga operatorë jo të certifikuar nga Albinspekt)</li></ul>   |
| Dokumentat shtese, për shitjet e produkteve të certifikuar NOP:             | <ul style="list-style-type: none"><li>Certifikatë fitosanitare</li></ul>  |
| Të tjera  | <ul style="list-style-type: none"><li>Cdo dokument tjetër që ju apo blerësit tuaj kërkojnë që të ngarkohet në sistemin TRACES</li></ul>   |

## Informacion Administrativ

Të gjitha aplikimet për COI duhet të dërgohen në [contact@albinspekt.com](mailto:contact@albinspekt.com) të paktën **2 ditë pune përpara dates së eksportit**.

Gjatë ditëve të javës, COI lëshohen:

- Në të njëjtën ditë nëse aplikimi është i plotë dhe dërgohet pranë Albinspekt para orës 12.00 (CET)
- Ditën tjetër nëse aplikimi është i plotë dhe dërgohet pranë Albinspekt më vonë se ora 12.00 (CET)
- Asnjë COI nuk lëshohet të Shtunën dhe të Dielën
- Aplikimet jo të plota do t'i kthehen dërguesit me kërkesën për të plotësuar mungesat

<sup>1</sup> Fatura duhet të përmbajë minimumi elementët si më poshtë: produkti, pjesa e produktit, sasia, statusi, numri i lotit, viti i vjeljes, aktiviteti i prodhimit, kodi i trupës së kontrollit, firmosja nga blerësi dhe shitësi



## **Analizat e produkteve**

Sipas vendimeve përkatëse të certifikimit disa produkte duhet të analizohen përpara shitjes së tyre si produkte organike.

Ju duhet të merrni masa që të njoftoni Albinspekt në kohë për qëllimin e shitjes së këtyre produkteve si organike në mënyrë që të kryhen të gjithë kontrollet e nevojshme si dhe marrja e kampionit pa ndikuar në datën e planifikuar për eksport nga ju si dhe lëshimin e Col-t.

Ju lutem mbani parasysh se kampionimi, transportimi i mostrave dhe analiza zakonisht zgjat nga 10 deri në 14 ditë pune.

Laboratorët ofrojnë procedura të shpejtuara me pagesë shtesë.

## **Të tjera**

Albinspekt rezervon të drejtën e kryerjes së kontrolleve fizike përpara lëshimit të Col-t tek të gjithë operatorët e tij. Këto kontrolle mund të kryhen në mënyrë të rastësishme apo të bazuar në rrezikun e produkteve apo operatorëve.

Për këtë arsye kërkesat tuaja për COI duhet të dërgohen të paktën **2 ditë pune përpara dates së eksportit**, në mënyrë që të shmangni çdo vonesë, nëse nevojiten sqarime apo verifikime në terren përpara lëshimit të COI.

Per cdo pyetje apo paqartësi ju lutem na shkruani në [contact@albinspekt.com](mailto:contact@albinspekt.com)

**Ju faleminderit për mirekuptimin!**

**Albinspekt**